



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**  
*Qeveria –Vlada - Government*  
**Ministria e Shëndetësisë - Ministarstva Zdravstva - Ministry of Health**

**Departamenti Shëndetësor i Burgjeve**

**PLANI I PUNËS PËR VITIN 2018**

Departamenti Shëndetësor i Burgjeve është transferuar nga MD ne MSh, bazuar ne Ligjin për shëndetësi Nr.04/L-125, neni 35, Marrëveshjen e Mirëkuptimit ne mes te MD dhe MSh, me numër 05-3527, te datës 13 Qershor 2013; si dhe Vendimin e Qeverise së datës 22.10.2014 me numër 02/201, është aprovuar UA 05/2014 nga QRK mbi Funksonimin e Shërbimit Shëndetësor te Burgjeve.

Me poshtë janë te paraqitura disa çështje kyçe te cilat planifikohet te zhvillohen gjate vitit 2018 me qellim te realizimit te objektivave baze dhe ne funksion te shëndetit te gjithmbarshëm te të burgosurve dhe stafit ne burgje.

| <i>Objektivi</i>   | <i>Aktiviteti Kryesor</i>   | <i>Periudha kohore</i>              | <i>Ndikimi Financiar</i>   | <i>Palët tjera të përfshira</i>  | <i>Ndërlidhja me dokumentin e politikave sektoriale</i>   |
|--|---|-------------------------------------|--|--|---|
| <b>1. Rritja e vazhdueshme e cilësisë se kujdesit shëndetësor</b>                              | <p><i>Monitorimi i vazhdueshëm i shërbimeve shëndetësore ne burgje;</i></p> <p><i>Trajnimi i stafit ne vazhdimësi i programuar:</i></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. <i>Trajnimi ne Emergjence, kardiologji dhe psikiatri,</i></li> <li>2. <i>Trajnimi ne bashkëpunim me Shëndetin Parësor ne tri module.</i></li> <li>3. <i>Rilicencimi i stafit shëndetësor.</i></li> <li>4. <i>Aplikimi i njohurive dhe te arriturave me te reja shkencore</i></li> </ol> | <i>Tere vitin, ne vazhdimësi</i>    | <i>Nuk ka kosto buxhetore</i>  | <i>DShB<br/>QKUK –<br/>Klinika<br/>Emergjente<br/>QZhVP<br/>Spitalet e<br/>Përgjithshme<br/>e<br/>Ambulanca<br/>e burgut</i> | <i>Bazuar ne<br/>UA 05/2014<br/>Ligjin për shëndetësi Nr.04/L-125;<br/>Ligjin për odat e profesionistëve shëndetësor</i>                                |
| <b>2. Integrimi i plotë i Departamentit Shëndetësor te Burgjeve ne kuadër te Ministrisë se</b> | <p>Implementimi i UA 05/2014 ne tërësi duke bere integrimin e vazhdueshëm te te gjitha shërbimeve duke ofruar kujdes shëndetësor te vazhdueshëm.</p> <p>Vazhdimi i bashkëpunimit me Shërbimin Korrektues te Kosovës , Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor e Prokurorial, Ombudpersonin, Këshillin e Evropës dhe</p>   | Gjate tere vitit 2018 ne vazhdimësi | I planifikuar<br>1. Staf 122;<br>2. Paga & mëditje 1,027,431.31 €;<br>3. Mallra dhe shërbime | MSh dhe buxheti i Kosovës.<br><br>Buxheti i aprovuar   | Buxheti nuk është i mjaftueshëm për te mbuluar te gjitha aktivitetet dhe shërbimet..<br><i>Të nevojshme edhe:<br/>Paga dhe mëditje;<br/>126,828,69€</i> |

|   |  |                       |   |   |  |
|---|--|-----------------------|---|---|--|
| <b>Shëndetësisë</b>   | <p>EULEX ne funksion te implementimit te proceduarve te harmonizuara me Këshillin e Evropës te shërbimeve duke avancuar dhe ruajtur autonominë profesionale.</p> <p>Rritja e numrit te stafit për se paku 7 pozita (psikolog, infermier dhe mjek)</p>  |                       | <p>320,00.00 €;<br/>4. Komunali<br/>2,000.00 €;<br/>5. Kapitale<br/>50,000.00€<br/><b>Total 1,399,431.31 €</b></p>  | është i pa mjaftueshëm                    | <p>Mallra dhe shërbime:<br/><b>50,000.00€</b><br/>Komunali:<br/><b>3,000.00€</b><br/>Ne total:<br/><b>179,828,69 €</b></p> |
| <b>3. Përpilimi dhe përfundimi i dokumentacionit legjislativ dhe proceduarve te punës</b> | <p>Vazhdimi i projektit te filluar për Përpilimin e protokolleve dhe proceduarve te punës se DShB ne bashkëpunim me Këshillin e Evropës.</p> <p>Trajnimi i stafit për implementimin e akteve ligjore.</p> <p>Trajnimi dhe implementimi i strategjisë sektoriale dhe protokolleve klinike ne njësitë shëndetësore te burgjeve.</p> <p>Integrimi i plote dhe i vazhdueshëm i DShB ne kuadër te organizmave relevante ne Rrjetin e OBSH-se për shëndetësi ne burgje te Evropës.</p>   | Gjate tere vitit 2018 | <p>Ka ndikim financiar te mbështetur nga KE</p> <p>Buxheti i parapare</p>   | MSh, KE dhe OBSH me donacione te mundshme | Është obligim qe del nga UA 05/2014  |
| <b>4. Kujdesi shëndetësor ekuivalent dhe i vazhdueshëm për te gjithë te burgosurit</b>    | <p>Shërbim infermierie 24 ore ne te gjitha NjShB dhe ne thirrje për mjeket.</p> <p>Shërbimi mjekësor 24 ne stacionarin e Burgut te Dubraves.</p> <p>Ofrimi i shërbimeve konsultative specialistike te përcaktuara ne UA 05/2014 sipas lemive dhe NJShB –ve dhe shtimi i tyre sipas kërkesës dhe nevojës..</p> <p>Aplikimi i plotë i proceduarve, formave administrative, formave te trajtimit dhe mënyrën e referimit sikurse sistemi shëndetësor publik.</p> <p>Implementimi i plote i menaxhimit elektronik te dosjeve mjekësore, dosjeve te stafit dhe menaxhimin e barërave përmes SISH.</p> <p>Vazhdimi i trajnimit te inspektoreve farmaceutik, shëndetësor dhe sanitar dhe monitoruesve te tjerë për inspektimin e shërbimeve shëndetësorë ne burgje konform specifikave dhe akteve ligjore, nënligjore dhe protokolleve specifike te punës.</p> <p>Implementimi i marrëveshjeve te bashkëpunimit me OJQ-</p> | Tere vitin 2018       | <p>Te parapara dhe te planifikuara ne buxhet</p> <p>Bazuar ne MM me ShSKUK, KEA, Labirint, KMDLNJ, etj, për mbështetje konsultat</p> <p>Te parapara me buxhet</p> | DShB<br>MSh<br>ShSKUK                     | Ligji, UA, Rregulloret dhe Protokollet   |

|   |   |                          |   |                                  |  |
|---|---|--------------------------|---|----------------------------------|--|
|   | të; KEA dhe Labirint si dhe mundësimin e aplikimit të marrëveshjeve të tjera në funksion të ngritjes së cilësisë së shërbimeve shëndetësore në burgje ekuivalente ato publike dhe transparente.   |                          |   |                                  |  |
| <b>5. Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe kuantitative specifike për burgje</b> | <p>Raportimi i rregullt, Monitorimi, parandalimi dhe trajtimi i sëmundjeve jo infektive, infektive, dhe epidemive eventuale.</p> <p>Monitorimi dhe trajtimi i disa indikatorëve specifik në burgje; <i>vete lëndimet, lëndimet trupore, abuzimet seksuale, tentim vetëvrasjet, grevat e urisë, vetmit dhe vdekjet.</i></p> <p>HIV/AIDS, TBC, HCV, HBV dhe drogat - Parandalimi, edukimi shëndetësor, trajtimi dhe rehabilitimi</p> <p>Trajtimet psikiatrike dhe psikologjike, bashkëpunimi me IPFK (Institutin e Psikiatrisë Forenzike të Kosovës).</p> <p>Vazhdimi i përpjekjeve për themelimin e Institucionit për trajtimin e personave me nevoja të veçanta në Dubrave.</p> <p>Mirëmbajtja dhe funksionalizimi i dhomave të sigurta në kuadër të ShSKUK.</p> <p>Aktivitete shtese të domosdoshme:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Vizita sistematike mujore e domosdoshme,</li> <li>2. Aplikimi i testeve psikologjike (1+2+3),</li> <li>3. Analiza e gjakut për të gjithë të burgosurit, një herë në vit</li> <li>4. Analiza e gjakut për të paraburgosurit sipas indikacioneve,</li> <li>5. Analiza e gjakut, specifike për përdorues të barërave psikotrope, një herë në vit,</li> <li>6. Vizite sistematike stomatologjike për të gjithë të burgosurit, 1 herë në vit,</li> <li>7. PAPA testi 1 herë në vit,</li> <li>8. Kontrollë gjinekologjike sistematike, 2 herë në vit,</li> <li>9. Kontrollë parandaluese e mamave, mamografia, 1 herë në vit,</li> <li>10. Kontrollë parandaluese për TBC 1 herë në vit,</li> <li>11. Screening për TBC në Dubrave, RTG të mushkërive për të gjithë, projekt</li> </ol> | Ne mënyrë të vazhdueshme | Buxheti i planifikuar.<br><br>Donacione nga donatore të tjerë eventuale | MSh<br>DShB<br>OIQ të involvuara | Parapare me ligj, rekomandime dhe rregullore |

|  |   |  |   |   |   |
|--|---|--|---|---|---|
| <p><b>6. Kujdesi farmaceutik për te gjithë te burgosurit falas sipas LESPK dhe Ligjit për Shëndetësi ne Kosove dhe rregullore te AKPM-se</b></p> | <p>Furnizimi me barëra dhe material mjekësor për te gjitha institucionet ne mënyrë te vazhdueshme, periodike.</p> <p>Monitorimi i vazhdueshëm i shpenzimeve përmes vizitave dhe sistemit elektronik si dhe monitorimi i mënyrës se përshkrimit.</p> <p>Kontrolli kualitativ i barërave dhe produkteve medicinale qe jepen ne burgje, duke përfshirë edhe ato qe i sjellin familjaret me kërkesën e te burgosurve.</p> <p>Mirëmbajtja dhe menaxhimi i kontratave për furnizime ne mënyre te vazhdueshme, pa ndërprerje dhe me kohe.</p> <p>Revidimi i vazhdueshëm i listës se barërave konform zhvillimeve shkencore dhe nevojave sipas gjendjes epidemiologjike.</p> <p>Ndërlidhja me Fondin e Sigurimeve Shëndetësore - FFSH lidhur me rimbursimin dhe shërbimet e tjera ne institucionet publike për te burgosurit.</p> | <p>Shpërndaj ne tri periudha kohore (sipas nevojës dhe kërkesave)</p> <p>Ne vazhdimësi</p>   | <p>Buxheti i planifikuar (152,310.00 €)</p> | <p>MSh, DShB<br/>Kompanitë kompetente</p> <p>Buxheti i nevojshëm <b>180,000.00€</b></p> | <p>Ne përputhje te plote me ligjet ne fuqi</p>  |
| <p><b>7. Mbajtja dhe monitorimi ne nivel te larte te kushteve higjienike sanitare te ne burgje</b></p>   | <p>Monitorimi i vazhdueshëm i kushteve higjienike sanitare te punëtoreve dhe burgjeve.</p> <p>Mostrimi i vazhdueshme i shujtave te ushqimit për çdo dite dhe ruajtja e tyre për 72 ore; evidentimi i kontrollit ne protokoll te veçanet.</p> <p>Pajisja me librezat sanitare për punëtor shëndetësor (1 here ne vit)</p> <p>Aplikimi i masave kunderepidemike dhe DDD neper te gjitha burgjet (3 here ne vite te gjitha hapësirat e brendshme dhe 1 here ne vite te gjitha hapësirat e brendshme dhe te jashtme, sipas kontratës dhe nevojave bazuar ne gjendjen epidemiologjike ne vend dhe ne burgje).</p> <p>Vizitat e rregullta sistematike mbi gjendjen shëndetësore te stafit.</p>  | <p>Ne vazhdimësi</p> <p>Sipas Ligjit për sëmundje infektive ne fuqi</p> <p>Ne vazhdimësi</p> | <p>Planifikuar ne buxhet</p>                | <p>MSh, DShB, ShKK, Kompania kompetente</p>   | <p>Parandalimi i përhapjes se ndonje epidemie dhe bazuar ne ligjet perkatese ne fuqi</p> <p>Ligji mbi mbrojtjen shëndetësore dhe sigurinë ne pune</p> |
| <p><b>8. Menaxhimi i mire i stafit</b></p>   | <p>Harmonizimi i numrit te stafit, pagës, shujtës,</p>  | <p>Gjatë gjysmës se</p>  | <p>Te planifikuara ne</p>                   | <p>MSh, DShB,</p>   | <p>Te planifikuar ne ligj, Urdhëresa nga Qeveria dhe me</p>   |

|  |   |  |                      |                      |  |
|--|---|--|----------------------|----------------------|--|
| <p><b>shëndetësore te burgjeve</b></p>                           | <p>rrezikshmërisë ne harmoni me UA 05/2014.</p> <p>Instalimi i sistemit elektronik te monitorimit te punës dhe aktiviteteteve te stafit ne NjShB.</p> <p>Monitorimi i respektimit te te drejtave te njeriut, kontratave, hierarkisë, pagesave, beneficioneve dhe ndëshkimeve sipas proceduarve.</p> <p>Fuqizimi i komisionit disiplinor, etik, te ankesave te te burgosurve, dhe formave tjera monitoruese si dhe aplikimi i masave shpërblyese deh ndëshkuese.</p>   | <p>pare te vitit 2018</p> <p>Gjate tere vitit 2018</p> | <p>buxhet</p>        | <p>MF</p>            | <p>UA 05/2014</p>  |
| <p><b>9. Monitorimi i vazhdueshme i kujdesit shëndetësor</b></p> | <p>Monitorimi i vazhdueshëm i gjendjes shëndetësore dhe indikatorëve te veçante qe e përcaktojnë kualitetin e gjendjes shëndetësore dhe shërbimeve shëndetësore.</p> <p>Inspektimi i rregullt nga Inspektorat sanitar, shëndetësor, farmaceutik, auditorët e brendshëm dhe te jashtëm dhe nga mekanizmat tjerë kontrollues te DShB. Aplikimi i standardeve dhe proceduarve te punës se DShB ne procesin e monitorimit dhe rekomandimeve.</p> <p>Monitorimi i implementimit te SISH si metode me e avancuar e monitorimit te vazhdueshëm te shërbimeve dhe kualitetit te tyre (bazuar ne shkallen e zhvillimit te tij ne MSh).</p> | <p>Ne vazhdimësi</p>                                   | <p>I planifikuar</p> | <p>MSh,<br/>DShB</p> | <p>Te parapara me ligj dhe ne funksion te ngritjes se cilësisë se shërbimeve</p> |